REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës:	2018:031930
Datë:	15.01.2020
Numri i dokumentit:	00763324

P.nr.1013/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtarja gjykuese Vjollca Bushala, me sekretarën juridike Drita Gërmizaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.H nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së, e duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1376-11/18 të dt.28.06.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Musli Gashi si dhe të akuzuarit B.H, me datën 24.12.2019, mori publikisht dhe shpalli ndërsa me dt.08.01.2020 përpiloi këtë:

A K T GJ Y K I M

I akuzuari:

B.H, nga i ati E., nga e ëma L. e vajzëris K., i lindur më ... në Prizren, ku edhe banon në rr. "..." nr...., me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me dt.08.03.2018, në shtëpinë e tij familjare e cila gjendet në rrugën "...", nr.63, në Prizren, i pandehuri me qëllim që të përfitojë nga shërbimi komunal përmes rrjetit përçues të rrymës, pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë direkte, para njësorit elektrik me nr. ... pa matjen në njësor, ashtu që energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar "...", Distrikti ligjor në Prizren i ka shkaktuar dëm material.

Me këto veprime ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 të KP-së.

Andaj, gjyqtari i vetëm, në bazë te neneve 4,7,8,9,10,17,39,46,48,49,69,70,71,72 të KP-së dhe neneve 248 dhe 365 KPP-së, të akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i vërteton, dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do te ekzekutohet, në afat prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Obligohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 € dhe shumën prej 30 € në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

E dëmtuara Ndërmarrja ... - Distrikiti Prizren, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil-juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1376-11/18 të dt.28.06.2018, kundër të akuzuarit B.H nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 të KP-së**.**

Pas pranimit të shkresave të lëndës, gjyqtarja e vetme gjykuese me datën 24.12.2019 ka caktuar shqyrtimin fillestar, ku i akuzuari pas udhëzimeve lidhur me të drejtat të cilat i takojnë sipas ligjit, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, e pranonë fajësin që i ngarkohet me aktakuzë.

I akuzuari ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet sipas dispozitivit të aktakuzës dhe ka kërkuar nga gjykata që t'i shqiptojë një dënim më të butë pasi që është i gjendjes tejet të rëndë ekonomike, i papunë ndihet tejet i penduar për veprimin e bërë dhe i garanton gjykatës që në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin.

Prokurori i Shtetit në fjalën e vet ka theksuar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë dhe se konsideron se pranimi fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, ku i akuzuari paraprakisht është udhëzuar nga gjyqtari gjykues për pasojat e pranimit të fajësisë.

Në shqyrtimin fillestar, gjykata pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë, në këtë aspekt, i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, në bazë të pranimit të fajësisë dhe provave tjera materiale nga shkresat e lëndës duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me dt.08.03.2018, në shtëpinë e tij familjare e cila gjendet në rrugën "...", nr...., në Prizren, i pandehuri me qëllim që të përfitojë nga shërbimi komunal përmes rrjetit përçues të rrymës, pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë direkte, para njësorit elektrik me nr. ... pa matjen në njësor, ashtu që energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar "...", Distrikti ligjor në Prizren i ka shkaktuar dëm material.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat.

2018:031931

Në bazë të cekurave më lart, gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit, formohen elementet e vepres penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 të KP-së Kodit nr. 06/L-74, per të cilën është edhe penalisht përgjegjës, andaj është shpallur fajtor dhe dënuar sipas ligjit duke i shqiptuar dënimin me kusht, ashtu që i ka vërtetuar, dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do te ekzekutohet, në afat prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Duke u bazuar në nenin 69 dhe 70 të KP-së, gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, pasi qe rrethana rënduese nuk pati, si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata pati parasysh sidomos faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë, është penduar thellë për veprën e kryer, dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do t'i përsëris veprimet e tilla inkriminuese apo të ngjashme.

Sipas bindjes së gjyqtarit gjykues, dënimi me kusht ndaj të akuzuarit, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lart, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësis së të akuzuarit.

Gjyqtari gjykues, gjithashtu ka konstatauar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 të KP-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës të dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 paragrafi 2 të KPP-së.

Vendimi mbi pagesën e paushallit gjyqësor është marrë në kuptim të nenit 454 par.1 të KPP-së.

Vendimi për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë në kuptim të nenit 39, të Ligjit nr 05/L-036 për Kompenzimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi, e në mbështetje të nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2018:031930, 15.01.2020

G j y q t a r i

_____

Vjollca Buzhala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.